Konfirmohet
Eriselda Sefo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE ASETEVE

Nr 1888 prot

Lushnjë ,më 19 / 02 /2026

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

PËR " PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE SHTETËRORE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS , DREJTORIA VENDORE LUSHNJE".

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Këshilltarë!

Pranë Institucionit të Bashkisë Lushnje është paraqitur 1(një) kërkesë nga **Z.Naim Ramazan Korreshi,** me objekt perfundimin e procedurës së privatizimit të banesës shtetërore.

Në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi , konkretisht:

- Vkm nr.97 , datë 03.02.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave".
- Ligji nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore",
- Ligji nr.9321, datë 25.112004 "Për Privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa , të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore;
- Vkm nr.179, datë 26.02.2020 "Për rregullat , kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qënë subjekt i Ligjit nr.7652, datë 23.12.1992";
-

rezulton se aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin të plotë ligjor , përkatësisht:

- Çertifikatën përkatësisht të vitit 1.12.1992;
- Mandat-arkëtimet që vërtetojnë shlyerjen e plotë të vlerës monetare të banesës sipas tarifave të përcaktuara në legjislacionin përkatës;
- Formularin nr.2 , ku pasqyrohen elementët e përllogaritjes së vlerës , kategoria dhe vendodhja e banesës;
- Formularin nr.3 (kontrata tip) me ish -Ndërmarrjen Komunale të Banesave
- Planimetritë dhe planvendosja e objektit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se aplikuesi ka përmbushur detyrimet financiare dhe procedurale për privatizimin e banesës , por mungon formalizimi përfundimtar i kontratës së

shitblerjes përpara noterit , çka ka sjellë mosregjistrimin e pronës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në këto kushte , për vijimin dhe përmbylljen e procedurës së privatizimit , kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak për përfundimin e procedurës dhe autorizimin për lidhjen e kontratës , me qëllim regjistrimin përfundimtar të pronës pranë Drejtorisë Vendore të Kadastrës Lushnje.

Sa më sipër , paraqitet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak.

Faleminderit për mirëkuptimin !

Konc:F.Korreshi

DREJTORI JURIDIK

Bedri Hida

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE ASETEVE

Nr 1888/1 Prot.

Lushnjë, më 19 /02 /2026

PROJEKT - VENDIM

NR. 24 DATË 19/02/2026

PËR " PËRFUNDIMIN E PROÇEDURËS SË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE SHTETËRORE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS , DREJTORIA VENDORE LUSHNJE"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ___/___/2026 në mbështetje të: Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, VKM Nr.97, datë 3.2.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", VKM Nr. 179, Datë 26.2.2020 "Për rregullat, kushtet dhe proçedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i Ligjit Nr. 7652, Datë 23.12.1992, "Për Privatizimin e Banesave Shtetërore", dhe të Ligjit Nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për Privatizimin e Banesave dhe Objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e Shoqërive dhe të Ndërmarrjeve Shtetërore " pika 5, pika 27 dhe 37, nenet 1 dhe 2 të Dekretit të Presidentit nr. 1440 datë 04.04.1996 "Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara" , neni 192 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë , paragrafi II "... regjistrimi i P.P të bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykatë apo të një organi tjetër shtetëror kompetent , si edhe në raste të tjera të parashikuara në ligj ..." si edhe nenit 193/b të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, **JU**

PROPOZOJMË :

I.Të përfundojnë procedurat e privatizimit të apartamentit dhe të lidhet kontrata e shitblerjes para noterit, për banesat të cilat kanë mbetur pa u regjistruar pranë ASHK–së,Drejtoria Vendore Lushnje, *sipas dokumentacionit përkatës të privatizimit të ndodhur në dosjet për qytetarin*

Z.Naim Ramazan Korreshi, vendndodhja e apartamentit: *lagjia "Loni Dhamo" , Njësia Administrative nr.3, Bashkia Lushnje*, lloji i pasurisë(apartament) , kati i 3,shkalla 1, e përbërë nga 1+1 (dhoma + kuzhinë) ,sipërfaqe 54.0 m2.

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lushnje ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së privatizimit para noterit.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORI JURIDIK
Bedri HIDA

KRYETARI I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE